

AKT THEMELIMI
I
SHOQERISE ANONIME
"EGNATIA TELEVISION "

Sot me date 11/05/ 2000 ne Elbasan

- 1-Lorenc Kita , I dtl 09-08-1966 , lindur dhe banues ne Tirane ,Rruga " Nikolle Tupe " No 3 , i pajisur me pashaporten nderkombetare me nr : 0594391 .
- 2-Edmond Kristo , I dtl 02-07-1963 , lindur dhe banues ne Elbasan ,lagja " Beqir Dardha No 1 , i pajisur me pashaporten nderkombetare me nr : 0293562 .
- 3-Antonio Tirino , I dtl 12-03-1953 , lindur dhe banues ne Moiano (BN) Itali , i pajisur me pashaporten nderkombetare me nr 533427 B . shtetas Italian .
- 4-Blerina Bracja , e dtl 20-12-1973 , lindur ne Gramsh dhe banuese ne Gramsh, lagja " Xhile Lici " Nr 115 , e pajisur me pashaporten nderkombetare me nr : 0167461 .

Vendosem :

Neni 1

Te themelojme shoqerine anonime "EGNATIA TELEVISION " SH.A.

Neni 2

Ne baze te legjislacionit shqiptar shoqeria eshte person juridik dhe veprimtaria e saj rregullihet ne baze te ligjit nr 7638 date 19-11-1992 , statutit te shoqerise dhe aktit te themelimit te kesaj shoqerie .

Neni 3

Selia e shoqerise

Selia e shoqerise eshte ne rrugen e Duresit , nr 210 Tirane , Shqiperi .

Ajo mund te transferohet ne cdo vend tjeter me nje vendim te keshillit mbikqyres me kusht qe te miratohet nga mbledhja me e afert e Asamblese se zakonshme te aksionereve Selia e shoqerise mund te transferohet jashte territorit te Republikes se Shqiperise me kusht qe te miratohet nga Asambleja e Jashtezakonshme e aksionereve .

Neni 4

Kohezgjatja e shoqerise

Kohezgjatja e Shoqerise eshte me afat te papercaktuar duke filluar nga data e rregjistrimit te saj ne rregjistrin tregtar .

Neni 5

Objekti i Shoqerise

Objekti kryesor i veprimtarise se shoqerise :

"Drejtimi I Televizionit dhe rrjetit televiziv , administrimi I tyre , vendosja dhe perdorimi I impianteve fikse dhe te levizshme per transmetim televiziv , mirembajtja , riparimi , installimi , montimi I makinave dhe I aparaturave elektronike dhe elektrike te telekomunikacionit ne funksion te veprimtarise se shoqerise , prodhim dhe eksport I aparaturave elektronike .

Sherbimet e reklames : Prodhimi I posterave dhe botime te tjera , shitje sherbimesh te ndryshme qe lidhen me objektin e shoqerise , prodhim dhe shumefishimi I kasetave , kompakt disqeve apo formave te tjera te permbajtjes audiovizive , shperndarja , marketingu distribuimi I tyre dhe aktivitete te tjera qe lidhen me si me siper si dhe organizmi dhe realizimi me bashkepunime me persona te tjere I spektakleve , varieteve televizive , etj "

Neni 6

Kapitali themeltar i Shoqerise

Kapitali themeltar eshte 25.030.000 (njetzetepesemilion e tridhjetemije) leke i cili perbehet nga kontributete ne natyre te ortakeve sipas listes se kontributeve .

Aksionet zoterohen perkatesisht nga :

- 1.Z.Lorenc Kita zoteron 25 % te aksioneve te shoqerise gjithsej
- 2.Z.Edmond Kristo zoteron 25 % te aksioneve te shoqerise gjithsej .
- 3.Z.Antonio Tirino zoteron 25 % te aksioneve te shoqerise gjithsej .
- 4.Z . Blerina Bracja zoteron 25 % te aksioneve te shoqerise gjithsej .

Neni 7

Shoqeria fillon veprimtarine e saj pas rregjistrimit ne rregjistrin tregtar te Gjykates se rrethit Tirana dhe per veprimtari qe kerkojne leje te vecante pasd nxjerrjes se tyre .

Pas rregjistrimit si person juridik shoqeria rregjistrohet ne zyren tatimore ku pajiset me certifikaten e rregjistrimit .

Neni 8

Oganet drejtuese te shoqerise

Oganet drejtuese te shoqerise jane :

- 1-Asambleja e Pergjithshme
- 2-Keshilli Mbikqyres
- 3-Drejtoria

Neni 9

Keshilli mbikqyres i shoqerise perbehet nga tre anetare ne rradhet e tij zgjidhet kryetari i saj .

Edmond Kristo

Lorenc Kita

Blerina Bracja

Edmond Kristo



Anetaret e pare te Keshillit mbikqyres dhe eksperti kontabel per here te pare zgjidhen per nje afat 3 vjecar .

Pas perfundimit te afatit te anetareve te keshillit mbikqyres dhe ekspertit kontabel emerimi dhe zgjedhja e tyre behet ne perputhje me kerkesat e ligjit " Per shoqerite Tregtare " .

Neni 10

Keshilli I pare Mbikqyres perbehet si meposhte :

Keshilli mbikqyres perbehet nga :

1.ANTONIO TIRINO	kryetar
2.EDMOND KRISTO	anetar
3.BLERINA BRACJA	anetar

Neni 11

Drejtori I pergjithshem I shoqerise caktohet : Lorenc Kita
Gjithashtu Ekspert kontabel I shoqerise emerohet z. Andon Kristo .

Neni 12

Kjo projekt kontrate eshte e vlefshme deri ne ditën e regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregtar.Prishja ose likuidimi I shoqerise behete neperputhje me statutin e shoqerise qe eshte pjese perberese e kesaj kontrate duke zbatuar rigorozisht rregullat e percaktuara ne ligjin " Per Shoqerite Tregtare .

Neni 13

Per pasqyrimin e veprimtarise se saj shoqeria do te plotesoje detyrimet , permbajtjen e dokumentacionit , te librit te aksionereve , pasqyrimin e aktivitetit dhe detyrimet e tjera te percaktuara ne ligjin per shoqerite tregtare dhe ne ligjet e tjera organike .


Neni 14

Shoqeria fillon veprimtarine e saj me nenshkrimin dhe dokumentimin e dokumentave te saj themeluese Themeluesit marrin persper te gjithe detyrimet e shoqerise momentin e regjistrimit ,

Ky akt themelimi eshte hartuar ne pese kopje me vlere te njejte ligjore .

Elbasan 11/05/2000

Aksioneret e shoqerise " Egnatia Televizion "


B. Bracja
Lorenc Kita
Andon Kristo

REPUBLIKA E E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE

Nr. 2838 Rep
Nr. 515 Kol

Elbasan me 11/105/2000

Vertetim

Sot ne Elbasan me date 11/105/2000 perpara meje noteres Anila Batalli u paraqiten personalisht :

- 5- Lorenc Kita , I dtl 09-08-1966 , lindur dhe banues ne Tirane ,Rruga " Nikolle Tupe " No 3 , i identifikuar nepermjet pashaportes nderkombetare me nr : 0594391 .
- 6- Edmond Kristo , I dtl 02-07-1963 , lindur dhe banues ne Elbasan ,lagja " Beqir Dardha No 1 , i identifikuar nepermjet pashaportes nderkombetare me nr : 0293562 .
- 7- Antonio Tirino , I dtl 12-03-1953 , lindur dhe banues ne Moiano (BN) Itali , i identifikuar nepermjet pashaportes nderkombetare me nr 533427 B . shtetas Italian .
- 8- Blerina Bracja , e dtl 20-12-1973 , lindur ne Gramsh dhe banuese ne Gramsh , lagja " Xhile Lici " Nr 115 , e identifikuar nepermjet pashaportes nderkombetare me nr : 0167461 .

Madhore dhe te afte per te kryer veprime juridike per identitetin e te cileve u sigurova nepermjet dokumentave te identifikimit , te cilet ne cilesine e aksionereve te shoqerise anonime " EGNATIA TELEVISION " SH.A kane firmosur aktin e themelimit te shoqerise ne pranine time si Notere pasi ky akt iu perkthye edhe shtetasit Italian Antonio Tirino ne gjuhen italiane nga perkthyesi Enver Lame .

Une noterja konfirmoj vertetesine e nenskrimeve te tyre te cilat jane vendosur ne pranine time dhe vertetoj se ne kete akt eshte shprehur vullneti i tyre i lire dhe i plote .
Une noterja e legalizoj kete akt ne baze te ligjit .

NOTERE

ANILA BATALLI



Anila Batalli

[Signature]

B. Bracja

Antonio Tirino



STATUT
I SHOQERISE " EGNATIA TELEVISION " SH.A

Kreu I

Dispozita te pergjithshme

Neni 1
Forma e Shoqerise

Shoqeria Anonime " EGNATIA TELEVISION" do te jete shoqeri anonime pa oferte publike persa kohe qe Asambleja e Aksionereve nuk do te marre nje vendim per shnderrimin e saj ne shoqeri Anonime me oferte publike , ose ne nje forme tjeter te shoqerise tregtare te parashikuar nga ligji nr 7638 " Per Shoqerite Tregtare" ,
Veprimtaria e shoqerise do te rregullohet nga dispozitat perkatese te ligjit te siperpermendur si dhe nga ky statut dhe nga legjislacioni ne fuqi .

Neni 2
Objekti I Shoqerise

Objekti kryesor I veprimtarise se shoqerise eshte :
"Drejtimi I Televizionit dhe rrjetit televiziv , administrimi I tyre , vendosja dhe perdorimi I impianteve fikse dhe te levizshme per transmetim televiziv , mirembajtja , riparimi , instalimi , montimi I makinave dhe I aparaturave elektronike dhe elektrike te telekomunikacionit ne funksion te veprimtarise se shoqerise , prodhim dhe eksport I aparaturave elektronike .
Sherbimet e reklames : Prodhimi I posterave dhe botime te tjera , shitje sherbimesh te ndryshme qe lidhen me objektin e shoqerise , prodhim dhe shumefishimi I kasetave , kompakt disqeve apo formave te tjera te permbajtjes audiovizive , shperndarja , marketingu distribuimi I tyre dhe aktivitete te tjera qe lidhen me si me siper si dhe organizmi dhe realizimi me bashkepunime me persona te tjere I spektakleve , varieteteve televizive , etj "

Neni 3
Emertimi I shoqerise

Emertimi I plote I shoqerise eshte : Shoqeria Anonime " EGNATIA TELEVISION".
Ne te gjitha aktet dhe dokumentat e nxjerra nga Shoqeria , emertimi I shoqerise " Egnatia Television " do te ndiqet nga fjalet Shoqeri Anonime ose SH.A.

Neni 4
Selia e Shoqerise

Selia e shoqerise eshte ne rrugen e Durresit , nr 210 Tirana Shqiperi .

Ajo mund te transferohet ne cdo vend tjeter me nje vendim te Keshillit Mbikqyres me kusht qe te miratohet nga mbledhja me e afert e Asamblese se zakonshme te aksionereve .

Selia e shoqerise mund te transferohet jashte territorit te Republikes se Shqiperise me kusht qe te miratohet nga Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionereve .

Neni 5

Kohezgjatja e Shoqerise

Kohezgjatja e shoqerise eshte me afat te papercaktuar duke filluar qe nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar .

KREU II **Aksionet dhe Aksioneret**

Neni 6

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 25.030.000 leke I ndare ne 25030 (njezetepesemije e tridhjetete) aksione me vlere nominale me nga 1000 leke secili .

Kapitali themeltar eshte 25.030.000 (njezetepesemilion e tridhjetemije) leke i cili perbehet nga kontributete ne natyre te ortakeve sipas listes se kontributeve .

Aksionet zoterohen perkatesisht nga :

1. Z.Lorenc Kita zoteron 25 % te aksioneve te shoqerise gjithsej ose 6257,5 aksione .
2. Z.Edmond Kristo zoteron 25 % te aksioneve te shoqerise gjithsej ose 6257,5 aksione .
3. Z. Antonio Tirino zoteron 25 % te aksioneve te shoqerise gjithsej ose 6257,5 aksione .
4. Z. Merina Bracja zoteron 25 % te aksioneve te shoqerise gjithsej ose 6257,5 aksione .

Neni 7

Ndryshimet e kapitalit themeltar

Kapitali themeltar ndryshohet ne te gjitha menytrat e modalitetet e kerkuara nga legjislacioni ne fuqi per kete qellim si :

Emetimi i aksioneve , rritja e vleres nominale te aksioneve , blerja e aksioneve nga shoqeria , etj .I vetmi organ kompetent per te vendosur ndryshimin e kapitalit eshte Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionereve e cila merr vendim ne baze te raportit te Drejtorise qe permban treguesit e kerkuar nga ligji .

Ne perputhje me ligjin Aksioneret kane perpjestimisht me shumen e aksioneve te tyre nje te drejte paresore me nenshkrimin e aksioneve te para , te emetuara ,per te kryer nje zmadhim kapitali .Ata mund te heqin dore nga kjo e drejte vetem individualisht .

Asambleja e jashtezakonshme vendos zvogelimin e kapitalit sipas dispozitave ligjore ne fuqi .Ne asnje rast zvogelimi i kapitalit nuk mund te cenoje barazimin ndermjet aksionereve .Zvogelimi i kapitalit ne nje shume me te vogel se minimumi ligjor mund te vendoset me kushtin pezullues te nje zmadhimi te kapitalit i destinuar te coje kete te fundit te pakten ne minimumin ligjor pervec rastit kur Shoqeria transformohet ne nje shoqeri te nje forme tjeter qe nuk kerkon kapital me te larte se ai i zvogeluar .

Ne rastin e mosrespektimit te kesaj dispozite cdo i interesuar mund te kerkoje nga Gjykata kompetente prishjen e Shoqerise .

Prishja e Shoqerise nuk mund te shpallet ne rast se ne ditën qe Gjykata shqyrton meshtjen gjendja eshte rregulluar .



Luciano Andronico

Blanca Dragaj

Edmond Kristo

Edmond Kristo

Neni 8

Statut dhe detyrat e aksionereve

Aksioneret e shoqerise jane persona fizike dhe juridike, qe kane vene ose do te vene ne zoterim aksionet e shoqerise ne te gjitha menytrat e parashikuara nga ligji .

Pronesia e aksionet e shoqerise permban aderimin me te drejta te plota ne statutin e shoqerise nepermjet perfaqesimit ne Asamblene e Pergjithshme te aksionereve .

Cdo aksioner i shoqerise ka te drejten e pjesmarrjes ne fitimet e shperndashme ne perputhje me aksionet e tij sipas vleres nominale te zoteruar prej tij ne kapitalin e shoqerise.

Cdo aksioner ka te drejte te marre, kur eshte rasti, nje teprice nga likuidimi I kapitalit ne perpjestim me vleren e aksioneve qe zoteron .

Aksioneret kane te drejten e votes dhe te perfaqesimit ne asamblene e pergjithshme te aksionereve me kushtet e parashikuara nga legjislacioni ne fuqi dhe ky statut .

Votat qe zoterojne aksioneret jane : proporcionale me perqindjet e aksioneve qe zoterojne.

Aksioneret e shoqerise jane vete pergjegjes per detyrimet dhe per humbjet e shoqerise deri ne librin e vleres nominale te aksioneve qe zoterojne .Pergjegjesia dhe kerkimi I fondeve te kesaj shprehje eshte e ndaluar .

Te drejtat dhe detyrimet e permendura me siper ndjekin aksionin ne cfaredo forme qe ai te tjetersonet tek te tretet .

Neni 9

Format e aksioneve dhe numri I aksioneve .

Aksionet jane te formes nominative .

Pronesia e aksioneve rezulton nga rregjistrimi I tyre ne emer te titullarit ose titullareve ne librin e aksioneve te mbajtura nga ana e shoqerise ose nga ndermjetesat finanziaire .

Libri I aksionereve do te permbaje ne cdo kohe informatat qe vijne , numrin dhe kategorine e aksioneve , daten e marrjes nga aksioneri , emrin , mbiemrin dhe adresen e cdo aksioneri si dhe vleren nominale per cdo aksion te zoteruar.

Secili aksioner ka te drejte te kerkoje me shkrim dhe te marre nje kopje nga libri I aksionere I cili vertetohet me vulen e shoqerise .

Secili aksioner ka te drejte te verifikoje nese emri I tij eshte futur ne librin e aksionereve dhe personi I cili nban librin eshte I detyruar ti tregoj aksionerit me kerkesen e ketij te fundit hyrjen perkatese ne liber .

Neni 10

Shitja dhe transferimi I aksioneve

Aksionet e shoqerise nuk jane lirisht te transferueshme tek te tretet.



Ato I nenshtrohen miratimit paraprak te Asamblese se zakonshme.

Ato mund tu shiten te treteve kur aksionet refuzohen te blihen nga aksioneret e tjere te shoqerise. Ato kane kushti I nenshtrohen dhe aksionet qe nenshkruhen ne rastin e zmadhimit te kapitalit te shoqerise .

Neni 11

Duke respektuar nenin 10 te ketij statuti ndryshimi I pronesise se aksioneve si rrjedhoje e nje shitjeje apo e nje transferimi , kryhen nepermjet nje kalimi nga llogaria e dhenesit tek llogaria e marresit ne baze te nje urdher xhirimi .

Shoqeria eshte e detyruar te kryeje kete rregjistrim dhe te kete xhirim brenda 6 diteve nga marrja e urdher xhirimit .



Urdhri I xhirimit I pergatitur ne nje formular te dhene nga Shoqeria ose te miratuar nag shoqeria nenshkruhet nga dhenesi I aksionit ose perfaqesuesi I tij.

Nese aksionet nuk jane shlyer teresisht urdher xhirimi nenshkruhet nga marresi .

Shoqeria duhet te kerkoje qe nenshkimet e paleve te vertetohen nga noteri ose organi I percaktuar me ligj per realizimin e transferimit te aksioneve pervec rasteve kur ky vertetim eshte perjashtuar nga ligji

Transferimi I aksioneve falas si rrjedhoje e trashegimise kryhet gjithashtu me ane te kalimit ne llogari ne baze te nje dokumenti ligjor qe verteton transferimin .

Shpenzimet per transferimin e aksioneve jane ne ngarkim te marresit pervec rastit te nje mmareveshje te kundert midis dhenesit dhe marresit .

Aksionet e pashlyera per derdhjet e kerkuara nuk mund te pranohen per transferim.

Neni 12

Shlyerja e aksioneve

Aksionet e nenshkruara me pare lidhur me zmadhimin e kapitalit te shoqerise duhet te shqyrtohen sipas modaliteteve te caktuara nga Asambleja e pergjithsme e jashtezakonshme .

Shlyerja e ketyre aksiove nuk mund te jete me e ulet sesa 1/ 4 e vleres nominale dhe nese eshte rasti e teresise se primeve te aksionit .

Shlyerja e vleres nominale te mbetur duhet te kryhet ne nje ose disa keste me kerkese te drejtorise se pergjithsme te shoqerise ne nje afat prej nje viti nga data kur ky zmadhim I kapitalit eshte bere perfundimtar.

Per shlyerjen e aksioneve kerkesat per fonde u behen te njohura nenshkruesve te pakten 15 (pesembedhjete) dite perpara dates se caktuar per cdo derdhje me leter rekomande , me kthim pergjigje per marrjen ne dorezim te adresuar tek cdo titullar I aksioneve .

Cdo vonese ne derdhjen e shumave te duhura nga shumat e pashlyera te aksioneve sjell pagimin e interesave me perqindje ligjore dhe kjo pavaresisht nga veprimi personal qe shoqeria mund te ushtroje ndaj aksionereve qe nuk shlyejne detyrimin dhe nga masat e zbatimit te detyruar te parashikuar nga legjislacioni ne fuqi per kete problem .

KREU III

Organet drejtuese te shoqerise

Neni 13

Organet drejtuese te shoqerise

Organet drejtuese te shoqerise jane :

1-Asambleja e Pergjithsme
2-Keshilli i mbikqyres

Drejtoria

Gjithashtu Ekspert kontabel I shoqerise eshte z. Andon Kristo .

Neni 14

Mbledhja e Asamblese

Asambleja e pergjithsme merr te gjitha vendimet te cilat jane te percaktuara nga ligji ose nga ky statut me perjashtim te rasteve kur vendimet perfshihen ne kompetencat e asamblese se jashtezakonshme

Kjo asamble do te mbahet ne 6-muajt e pare te cdo viti fiskal .Ajo merr vendim me nje shumice votash te parashikuar nga neni 129/ 2 dhe 129/ 3 I ligjit 7638 date 19-11-1992 "Per Shoqerite Tregtare

Mbledhjet e Asamblese se shoqerise mbahen ne seline e shoqerise ose ne nje vend tjeter te pershtatshem per aksioneret .

Mbledhja e Asamblese kryhen me ane te nje lajmerimi qe permban informacion ligjor ne menyre te tille qe te jete nje periudhe kohe prej te pakten 15 ditesh ndermjet dites se publikimit dhe dites se fundit per depozitim .

Neni 15

E drejta e votes

Cdo vlere nominale prej 1000 lekesh perfaqeson vetem nje vote .E drejta e votes mund te ushtrohet me ane te nje autorizimi per te cilin kerkohet nje forme e shkruar (prokure e posacme). Kushtet ne baze te te cilave aksion-mbajtasi mund te ushtroje te drejten e votes ne Asamble , percaktohet ne ftesen per te marre pjese ne asamblene e aksionereve per aq kohe sa nuk jane dhene certifikatat e aksioneve .

Neni 16

Kryetari I Asamblese se aksionereve

Mbledhjet e Asamblese se aksionereve drejtohen nga kryetari I keshillit mbikqyres ose ne mungese te tij nga persone parashikuar ne statut , perndryshe vete asambleja zgjedh drejtues te mbledhjes se saj .

Ne rast te thirrjes se Asamblese nga ekspertet kontabel te autorizuar nga nje mandatmbajtes I autorizuar nga Gjykata ose nga likuiduesit ,mbledhja e Asamblese drejtohet nga personat ose njeri nga personat qe kane thirrur kete mbledhje .

Kryetari drejton Asamblene dhe vendos mbi vazhdimesine , objektet e diskutimit dhe mbi menyren e votimit .

Drejtimi I mbledhjes se asamblese bazohet ne parashikimet e nenit 48 te ligjit nr 7667 date 28-01.1993 per regjistrimin tregtar dhe formalitete qe duhen plotesuar nga shoqerite tregtare .

Neni 17

Quorumi

Asambleja formon nje quorum nese jane perfaqesuar te pakten 25 % e aksioneve me te drejte vote .

Neqoftese perfaqesimi eshte me pak se 25 % thirret menjehere nje mbledhje e dyte e cila formon nje quorum pa marre parasysh perfaqesimin e aksioneve ne votim nese kjo pike eshte percaktuar ne statutin me perjashtim te rasteve kur per marrjen e vendimit te hartuar ne rendin e dites kerkohet qe ligj nje mazhorance me e larte .

Vendimet e Asamblese merren me shumicen e thjeshte te votave me perjashtim te rasteve kur ligji e parashikon ndryshe .


Ne raste te tjella,kur ligji percakton mazhorance te kapitalit ne para qe shoqeria ka ne dispozicion te saj te ekziston ne kohen e miratimit te rezolutes , do te jete e mjaftueshme nje mazhorance e thjeshte e kapitalit themelor ekzistues nese ligji nuk parashikon nje mazhorance me te larte .

Nese mazhoranca e thjeshte nuk arrihet me votimin e pare atehere ndermjet dy personave qe kane numrin me te madh te votave do te zhvillohet nje votim perfundimtar .


Ne rastin e barazimit te votave ne balotazhin e dyte do te hidhet short .

Neni 18

Rradha e paraqitjes se dokumentave



B. Broz



Perdoro Andon

Rendi I dites I mbledhjes se asamblese se aksionereve percaktohet nga autoriteti qe therret Asamblese
Drejtorja e Shoqerise duhet ti paraqese keshillit mbikqyres dokumentat ligjore ne lidhje me aktivitetin e shoqerise gjate vitit te fundit sipas kerkesave ligjore ne tre muajt e pare te cdo viti fiskal
Bilancet finaziare ne fund te vitit raporti mbi aktivitetin , raporti I keshillit mbikqyres dhe te gjitha projekt vendimet dhe dokumentet e tjera te parashikuara ne ligj duhet te paraqiten 15 dite perpara asamblese ne seline e aktivitetit te shoqerise per tu shqyrtuar nga aksion- mbajtesit ose tu dergohen atyre ne baze te kerkeses se tyre .

Cdo vit pas marrjes se raportit I cili duhet ti dorezohet keshillit mbikqyres brenda 6 muajve te pare te viti ushtrimore, asambleja vendos mbi zevendesimin e drejtorise se shoqerise dhe keshillit mbikqyres mbi perfundimin e perfitimit neto te vitit dhe ne rastet e tjera te parashikuara me ligj mbi percaktimin e treguesve.

Asambleja vendos per marrjen e kredive ose te huave per te siguruar mjetet finaziare te perkohshme afatgjata ose afatshkurtra si dhe ne forma te tjera te mundshme sipas normave qe lejojne mobilizimin e mjeteve finaziare .

Nga krijimi I fondit I rezerve dhe krijimi I fondeve te tjera te finazimit asambleja e zakonshme vendos zhvillimin dhe zgjerimin e aktivitetit , vendos per investime ne shoqeri ose instituzione te ndryshme vendase ose te huaja ,pervec rasteve qe jane ne kompetence te asamblese se jashtezakonshme .

Neni 19

Asambleja e Jashtezakonshme

Asambleja e jashtezakonshme merr te gjitha vendimet e parashikuara ne kete statut dhe nga dispozitat ligjore perkatese si kompetence e saj , pervec atyre kompetencave qe me ligj ose me statut bejne pjese ne kompetencat e Asamblese se zakonshme te pergjithshme

Cdo aksioner ka te drejte te marre pjese ne mbledhjet e Asamblese se jashtezakonshme .

Vetem Asambleja e jashtezakonshme ka te drejte te ndryshoje statutin me te gjitha dispozitat e tij Menytrat e thirrjes dhe te mbledhjes se asamblese se jashtezakonshme jane te ngjashme me ato te asamblese se zakonshme .

Asambleja e jashtezakonshme mund te marre vendime te vlefshme vetem ne rast se aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar zoterojne ne mbedhjen e pare te pakten 1/ 2 e aksioneve dhe ne te dyten 1/ 4 e aksioneve me te drejte vote .

Asambleja e jashtezakonshme merr vendim me nje shumice votash prej 3 / 4 qe u perkasin aksionereve te pranishem ose te perfaqesuar .

Keshilli mbikqyres

Neni 20

Perberja e keshillit mbikqyres

Keshilli mbikqyres perbehet nga tre anetare .

Anetaret e keshillit mbikqyres mund te jene persona fizike apo juridike ne perputhje me dispozitat ligjore te ligjit nr 7638 " Per shoqerite tregtare " .

Koha e ushtrimit te detyres per te gjitha anetaret eshte 4 vjet .

Asnje anetar I keshillit mbikqyres nuk mund te jete anetar I drejtorise .

Ne rast se ai emerohet si I tille mandati I tij perfundon sapo ai te kaloje ne funksionin e ri .

Anetaret e Keshillit mbikqyres mund te japin doreheqjen nga detyra me ane te nje deklarate me shkrim e cila duhet ti dergohet kryetarit te keshillit mbikqyres duke respektuar njelimit kohë prej 2 javesh .

Perdhan Anthonano

Shprehimi I anetareve te keshillit mbikqyres do te caktohet me vendimin e Asamblese se aksionereve .

Neni 21

Te drejtat dhe detyrat e keshillit mbikqyres

Keshilli mbikqyres kontrollon drejtorine e shoqerise dhe eshte pergjegjes per heqjen e detyrave dhe mbrojtjen e te drejtave te cilat I kalojne me ane te ligjit , statutit ose ne ndonje forme tjeter .

Keshilli mbikqyres ka te drejte te therrase asmablene e aksionereve .

Keshilli mbikqyres ka kompetencen te beje ndryshimet e nevojshme ne statutin e shoqerise duke ia paraqitur me pas per miratim Asamblese me te afert te aksionereve .

Keshilli mbikqyres emerone drejtorine dhe cakton drejtorin e shoqerise .

Keshilli mbikqyres mund te percaktoje nje liste te atyre masave dhe veprimeve te cdilat mund te merren nga drejtoria e shoqerise .

Keto I nenshtrohen mareveshjes fillestare te Keshillit Mbikqyres . Kjo eshte e vlefshme sidomos per politiken e objekteve te biznesit , Investimit dhe financimit , fushat e veprimet te shoqerise dhe personelit dhe drejtimin e kontrates .

Keshilli mbikqyres ka te drejte te mbikqyre ne cdo kohe menagjimin e plote te drejtorise se shoqerise .

Ne ketë menyre mund te shihen dhe inspektohen nga keshilli mbikqyres edhe librat , rregjistrimet dhe qellimet e shoqerise .

Drejtoria e shoqerise eshte e detyruar te vere ne dijeni keshillin mbikqyres sipas menyres se percaktuar ne ligj .

Perveç kesaj keshilli mbikqyres mund te kerkoje nje raport per problemet e shoqerise , maredheniet ligjore dhe te biznesit me shoqerite qe ka lidhje si dhe per aktivitetet e biznesit qe jane me rendesi per pozicionin e aksiombajtesve .

Deklaratat e keshillit mbikqyres do te jepen ne emer te ketij keshilli nga kryetari dhe ne mmungese te tij nga Zv.Kryetari .

Gjate kryerjes se detyrave te tij keshilli mbikqyres mund te vleresoje vete mbi kualifikimin e pales se trete per mbeshtetjen e tij .

Gjithashtu pala e trete mund te marre pjese ne mbledhjet e e keshillit mbikqyres si si keshilluese .

Neni 22

Zgjedhja e Kryetarit te Keshillit mbikqyres

Keshilli mbikqyres zgjedh midis anetareve te tij nje kryetar dhe nje zevendes per kohen e ushtrimit te detyres ne nenin 21 te ketij statuti .Zgjedhja e tyre behet ne mbledhjen e pare qe thirret pas mbledhjes se se pergjithshme te aksion- mbajtesve ne te cilen eshte zgjedhur ky keshill .

Ne qifte se kryetari ose zevendesi I tij lirohen nga detyra para mbarimit te afatit , do te kryhet nje zgjedhje tjeter per periudhen e mbetur nga koha e ushtrimit te detyres se personave qe jane liruar .




Ne pamundesi ardhjejeje te kryetarit dhe zevendesit te tij gjate kesaj kohe , detyrat do te kryhen nga anetari me I vjeter ne moshe .

Keshilli mbikqyres mund te caktoje rregulla te brendshme lidhur me proceduren e punes Vendimet mund te nxirren vetem nga Keshilli Mbikqyres ,Drejtoria e shoqerise mund te marre pjese ne mbledhjen e Keshillit Mbikqyres .

Neni 23

Mbledhjet e Keshillit Mbikqyres

Mbledhjet e keshillit mbikqyres thirren me shkrim nga kryetari dhe ne pamundesi ardhjeje nga zevendesi I tij .Lajmerimi behet 15 dite perpara .Ne rast urgjence lajmerimi mund te behet brenda



nje kohe me te shkurte dhe ftesa mund te komunikohet gojarisht , me telefon , teleks ose telegraf .

Ne kete rast duhet te secifikohen rendi I dites dhe sugjerimet e vendimeve .

Ndonje anetar I keshillit mbikqyres mund te shtroje ceshtje ne rendin e dites te cilat duhet t'i behen te njohura kryetarit me ane te nje letre te pakten 10 dite perpara mbledhjes .

Te gjitha anetaret e tjere te Keshillit duhet te Informohen pa vonese mbi shtesat e rendit te dites .

Neni 24

Miratimi dhe marrja e vendimeve ne Keshillin Mbikqyres .

Nese te gjitha anetaret e Keshillit Mbikqyres jane te ftuar ne kohen e duhur dhe nese te pakten gjysma e numrit legal te tyre merr pjese ne miratimin e nje rezolute ,atehere Keshilli Mbikqyres formon nje quorum anetaresh qe duhet te jete prezent per te konsideruar nje mbedhje te vlefshme .

Miratimi I nje rezolute e cila nuk ka qene e perfshire ne rendin e dites eshte e lejueshme vetem nese asnje nga anetaret e pranishem te Keshillit Mbikqyres nuk e kundersizton rezoluten dhe te pakten dy te tretat e anetareve jane te pranishem .

Mbledhja do te drejtohet nga kryetari dhe ne rast se ai nuk eshte I pranishem nga zevendesii tij . Kryetari vendos rradhen e rendit te dites , llojin dhe rradhen e votimit .

Vendimet mund te miratohen vetem nga mbledhjet e Keshillit mbikqyres me shumicen e thjeshte me perjashtim te rasteve kur ligji parashikon ndryshe.

Ne rast barazimi votash do te ndermerret nje tjetër diskutim lidhur me ceshtjen konkrete vetem nese shumica e Keshillit Mbikqyres vendos per kete ,perndryshe do te behet nje njoftim tjetër I menjehershëm .

Nese dhe rezultati I votimit te te dyte eshte I barabarte atehere kryetarit I jepet e drejta e dy votave .

Procesverbalet e mbledhjeve te Keshillit Mbikqyres dhe te Komiteteve nese ekzistojne duhet te pergatiten dhe te nenshkruhen nga drejtuesi perkates I mbledhjes .

Neni 25

Informacionet konfidenciale

Anetaret e Keshillit Mbikqyres duhet te ruajne menyren e gjykimit dhe te veprimit ne lidhje me informacionin konfidencial dhe sekretet e shoqerise , vecanerisht ato dhe te biznesit per per te cilat ata jane te vetedijshme nepermjet punes se tyre .Kjo mbetet e vlefshme edhe pas largimit nga Keshilli Mbikqyres .Informacioni lidhur me shoqerine mund tu transferohet te treteve vetem me miratimin e kryetarit te Keshillit dhe me kusht qe transferimi nuk rrezikon interesat e shoqerise.

DREJTORIA E SHOQERISE

Neni 26

Perberja e Drejtorise

Drejtoria e shoqerise perbehet nga nje person fizik I cili eshte edhe aksioner I shoqerise .




Keshilli mbikqyres I shoqerise anonime " Egnatia Televizion " emerom drejtor te pergjithshem te saj Z. Lorenc Kita .

Lejohet emerimi I anetareve zevendes te drejtorise .Ata kane te drejta te njejta sikurse anetaret e tjere te Drejtorise persa I perket formes se jashtme te perfaqesimit .

Do te kryhen nga keshilli Mbikqyres

-Percaktimi I numrit te anetareve te Drejtorise se Shoqerise (bordi drejtues) .

-Perfundimi I I kontratave te punesimit me anetaret e Drejtorise .



- Revokimi I emerimeve te anetareve te drejtorise
- Emerimi I nje anetari si Drejtor I Pergjithshem

Neni 27
Votimi

Nese bordi drejtues perbehet nga disa persona do te percaktohet rregullat e perhershme te cilat do ti nanshtrohenmiratimit te Keshillit Mbikqyres .
Vendimet e Drejtorise do te miratohen me shumice votash .Ne rast barazie votash , vota e kryetarit te Drejtorise do te jete percaktuese .Nese ai nuk eshte I pranishem atehere vota e zevendesit te tij mbetet decizive .

Neni 28
Detyrat e Drejtorise

Drejtoria e shoqerise eshte e detyruar para shoqerise te respektoje kufizimet e percaktuara me ligj statut dhe nga Keshilli Mbikqyres lidhur me hapesiren e autoritetit te tij drejtues .

KREU IV

NENI 29
Ndarja dhe bashkimi

Shoqeria mund te ndahet ose te bashkohet me shoqeri te tjera me vendim te Asamblese se Jashtezakonshme me shumicen e votave te aksionereve te caktuara per ndryshimin e statutit te shoqerise .
Ne rastin e ndarjes ,bashkimit te shoqerise do te zbatohen dispozitat e seksionit IV te ligjit nr 7638 date 19/11/1992 " Per Shoqerite Tregtare " .




Neni 30
Likuidimi

Likuidimi I shoqerise vendoset nga Asambleja e Jashtezakonshme e aksionereve kur per kete jane dakort shumica e quorumit per marrjen e vendimve ne kete asamble .
Vendimi I likuidimit te shoqerise duhet tu behet I njohur te gjithë aksionereve te shoqerise nepermjet publikimit te tij me mjetet e informacionit publik .
Aksioneret te cilet zoterojne aksione ne masen e parashikuar ne nenin 139 te ligjit nr 7638 date 19/11/ 1992 kane te drejte te kundershtojne ne rruge gjyqesore vendimin e marre nga Asambleja e Jashtezakonshme .
Procesi I likuidimit te shoqerise do te behet ne perputhje me dispozitat e seksionit V te ligjit Nr. 7638 date 19/ 11 / 1992 " Per Shoqerite Tregtare " .

Neni 31
Vula e shoqerise

Vula e shoqerise ka forme te rrumbullaket dhe brenda saj eshte shenuar " Republika e Shqiperise "EGNATIA TELEVISION " SH.A ne mes eshte pozicionuar Simboli I Paraboles dhe poshte me germa te medha dhe te ndara eshte shkruar Albania .

KREU V
Dispozita te fundit



Per ceshtjet qe nuk parashikohen dhe nuk rregullohen nga ky statut vlejne dispozitat e ligjit Nr. 7638 date 19/11/12992 , dispozitat e ligjit nr 7667 date 28-01-1993 " Per Rregjistrimin dhe formalitetet e tjera " si dhe aktet e tjera ligjore dhe nenligjore qe rregullojne qe rregullijne kete veprimtari .



Elbasan me 11/05/2000

AKSIONERET

Lorenc Kita Lorenc Kita

Edmond Kristo Edmond Kristo

Antonio Tirino Antonio Tirino

Blerina Bracja Blerina Bracja



[Signature]

[Signature]

[Signature] Antonio Tirino